REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 384/13 Data: 15.01.13
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Numër: 384/13
Datë 15.01.13

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 15.12.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e Qendrës për Trajnim dhe Zhvillim "PTK" për periudhën: 15/12/2012 - 31/07/2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. Teknologji Informative dhe e komunikimit - Operator i IT-së (III)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Pjerrina në hyrje të ndërtesës mungon. Rekomandohet që të ndërtohet pjerrina në mënyrë që të ju mundësohet qasja edhe personave me aftësi të kufizuara (personave me karroca).
- Sallat e trajnimeve e kanë dyshemenë e dyfishtë për shkak të shtrirjes së kabllove, por kjo dysheme ka shkaktuar një pengesë për hyrjen në laborator të personave me aftësi të kufizuara (personave me karrocë)
- Laboratorëve të trajnimeve u mungon ndriçimi natyral dhe preferohet që ndriçimi të jetë natyral.

- Objekti i bufesë është në katin e dytë dhe meqenëse nuk ka ashensor është e vështirë që personat me karroca të kenë qasje në këtë pjesë.
- Rekomandohet që numri i kredive të jetë i plotë dhe mos të jetë me presje dhjetore.
- Programi i zbatuar për trajnimin e ECDL ka si përmbajtje sistemin operativ Windows XP dhe Microsoft Office 2003. Rekomandohet që të bëhet freskimi i programit, në mënyrë që kandidatëve të mund të ju ofrohet trajnimi për versionet e fundit të sistemit operativ dhe paketës së Office-it.
- Rekomandohet që libri i cili përdoret nga kandidatët gjatë kohës së trajnimit të mund të përdoret edhe për një kohë pas përfundimit të trajnimit në mënyrë që kandidatët të mund të praktikojnë sa më mirë ato që kanë mësuar gjatë trajnimit.

Afati përmbushjes se këtyre kushteve është: 01.07.2013

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë:15.12.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

- QTZH "PTK;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi